

Pantomimë, lojë me role, bashkëpunim

Stafeta e Pishtarit – gjeni rendin e saktë

Kohëzgjatja: 30 minuta

Audienca e kërkuar: Fëmijë të moshës 9 deri në 12 vjeç

Pajisjet e nevojshme:

- Foto të stafetës së pishtarit (automjete dhe vrapues) dhe ceremonia e ndezjes së flakës në Olimpia (shtojca 1)
- Fletët që do t'i shpërndahen pjesëmarrësve (shtojca 2)

Stafi: 1

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit

"Flaka arrin në qytetin pritës nga mijëra mbajtës të stafetës: sportistë të famshëm ose jo, por mbi të gjitha, nga shumë njerëz të zakonshëm. Ajo njofton ardhjen e Lojrave dhe përhap mesazhin e paqes, bashkimit dhe miqësisë midis njerëzve".

Çdo pjesëmarrës duhet të përpiqet të gjejë pozicionin e tij të saktë në stafetën e pishtarit Olimpik duke respektuar, kuptuar dhe duke përdorur gjepte dhe gjuhë jo-verbale për të komunikuar me vrapuesit e tjerë të cilët do të pasojnë stafetën. Çdo vrapuesi i jepet një kartë që vërteton se ai është mbajtës i pishtarit Olimpik. Qëllimi është gjetja me lehtësi e identitetit të vrapuesit të radhës, duke i gjetur vendin dhe kohën e saktë pasi transportimi i flakës nga Olimpia e deri në mbëritjen e pishtarit në stadiumin Olimpik duhet të bëhet nga të gjithë mbajtësit e pishtarit pa thënë asnjë fjalë, pra me gjepte.

Ky seminar u tregon pjesëmarrësve për simbolikën e stafetës së pishtarit Olimpik dhe i ndihmon ata të mësojnë rreth mbajtësve të pishtarit dhe mënyrave të ndryshme që përdoren për transportin e Flakës Olimpike .

Loja u mëson fëmijëve të përdorin pantomimën, shprehje të ndryshme të fytyrës, gjepte dhe gjuhën e trupit, në mënyrë që ata të hyjnë në karakter dhe në rolin e mbajtësit të stafetës. Gjithashtu, ajo u ofron fëmijëve një mundësi për të shprehur vetveten, dhe u jep atyre përvojën e të qenit aktor dhe spektator.



Udhëzime

Para seminarit

- Familjarizohuni me stafetën e pishtarit dhe simbolikën e saj.
- Shihni dokumentat referuese mbi pishtarët Olimpikë dhe stafetën e pishtarit:

<http://www.olympic.org/content/the-olympic-museum/visit/schools/teaching-resources/support-de-course/the-Olympic-flame-and-the-torch-relay/>

<http://olympicjourney.olympic.org/?l=en>

<http://olympicjourney.olympic.org/?l=en#/en/the-torches:-design-and-symbolism/273>

Gjatë seminarit

- Pyesni fëmijët se çfarë dinë në lidhje me stafetën e pishtarit, çfarë simbolizon ajo, si është transportuar flaka dhe çfarë dinë ata në lidhje me njerëzit që mbajnë pishtarin. Tregoni fotografi të mbajtësve të pishtarit Olimpik dhe përmendni shembuj të llojeve të ndryshme të transportit të përdorura për Flakën Olimpikë (shih fotot bashkangjitur). Flisni për stafetën e pishtarit në Lojërat e ardhshme Rio 2016 (shih shtojcën 3).
- Prezantoni lojën, shpjegoni qëllimin dhe rregullat e saj. Theksoni se loja duhet të zhvillohet në qetësi të plotë dhe tregojuni gjeste apo shprehje të fytyrës që do të përdoren për të komunikuar me lojtarët e tjerë (përcaktoni në grup se cili sinjal do të thotë "po" dhe cili "jo", "përshkruani me gjeste personazhin tuaj", "ti je para meje", "ti je pas meje" dhe "ti nuk je ai që po kërkoi").
- Pajisni çdo pjesëmarrës me një fletë të personazhit që përfaqëson. Në çdo fletë tregohet identiteti i personazhit që e mban, si dhe identiteti i mbajtësit të pishtarit përpara dhe pas tij në stafetë. Fletët mund të merren nga katalogu i fletëve të treguara në (Shtojca 1) dhe duhet të përshtaten në përputhje me madhësinë e grupit dhe moshën e pjesëmarrësve.
- Çdo lojtar merr kohën e nevojshme për të studiuar fletën e tij. Qëllimi i lojës është që të formohet rendi i saktë i kalimit të pishtarit nga personi i cili ndez flakën në Olimpia deri tek personi që e çon dhe e ndez flakën në stadiumin Olimpik. Për të gjetur rendin e duhur të mbajtësve të pishtarit, nevojitet që fëmijët të gjejnë se cili nga shokët vjen para dhe pas tij.
- Për të realizuar këtë, lojtarët duhet të lëvizin rreth e qark dhe të ndërveprojnë me njëritjetrin me gjeste e mimikë por pa folur.
- Lojtarët komunikojnë duke përdorur duart, shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit. Kur dy lojtarë ndërveprojnë, që të dy përshkruajnë me gjeste personazhin që përfaqësojnë dhe duhet të përpiqen të gjejnë identitetin e lojtarit tjetër.
- Kur një lojtar ka gjetur kush është para dhe pas tij, atherë ai pozicionohet midis tyre.
- Në këtë mënyrë loja përparon, dhe formohet sekuenca e vendosjes së lojtarëve, pa folur.
- Kur të jetë formuar rendi i saktë loja quhet e mbaruar, dhe në përfundim të saj secili lojtar zbulon identitetin e tij dhe tregon fletën ose kartën e personazhit që përfaqësonte.

Variacione të lojës për grupe të mëdha

- Ndajini pjesëmarrësit në dy ose më shumë grupe.
- Grupi që gjen rendin e saktë më shpejt është grupi fitues.

Shpjegoni qartë se aspekti konkurrues është pjesë e lojës por jo pjesë e stafetës së pishtarit.

SHTOJCA 1

Imazhe të stafetës së pishtarit

Ndezja e pishtarit në Olimpia



Mbajtësit e pishtarit



Hyrja në stadium



Ndezja e pishtarit në stadiumin Olimpik



SHTOJCA II

Kartë personazhi për printim

Këto tetë fletë personazhesh janë për t'u printuar, prerë dhe për t'u shpërndarë.

Priftëresha e Olimpias (Greqi)

Unë jam:

Një aktore që luan rolin e një priftëreshe të Olimpias. Unë jam një vajzë e re dhe e bukur dhe mbaj veshur një fustan të bardhë. E mora flakën në një urnë/enë qeramike. Flaka Olimpike ndizet në një urnë për herë të parë në Olimp.

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Mbajtësit të parë të pishtarit

Mbajtësi i parë i pishtarit

Unë jam:

Një burrë 40 vjeçar. Unë jam i gjatë dhe i fortë, dhe bëj shumë sport.

E kam marrë flakën nga:

Priftëresha e Olimpias

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Një djali të ri në karrige me rrota

Djalë i ri në karrige me rrota

Unë jam:

Një i ri 23 -vjeçar paraplegjik. Unë kam përdorur gjithmonë karrige me rrota, dhe ndihem rehat i ulur në të si dhe mund të lëviz me shpejtësi mbi të.

E kam marrë flakën nga:

Mbajtësi i parë i stafetës

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Notarit

Notari

Unë jam:

Një ish notar, tani jam 55 vjeç dhe do t'a transportoj flakën duke notuar përgjatë një lumi.

E kam marrë flakën nga:

Nga një djalë i ri në karrige me rrota

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Këngëtarit

Këngëtarit

Unë jam:

Një këngëtar shumë i famshëm në vëndin tim. Të gjithë i kanë dëgjuar këngët e mia.

E kam marrë flakën nga:

Notari

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Një bujku të moshuar

Bujku i moshuar

Unë jam:

Një bujk 88 -vjeçar dhe kam jetuar gjithë jetën time në fshatin ku do të kalojë flaka Olimpikë. Mua mu kërkua të isha një nga mbajtësit e flakës dhe ky është një nder i madh për mua.

E kam marrë flakën nga:

Këngëtarit

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Njeriut mbi deve

Njeriu mbi deve

Unë jam:

Një njeri që udhëtoj me deve. Unë do ta transportoj flakën mbi deve. Kjo është fantastike. Po i afrohem stadiumi.

E kam marrë flakën nga:

Një bujk/fermer i moshuar

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Mbajtësit të fundit të pishtarit.

Mbajtësi i fundit i pishtarit

Unë jam:

Një ish atlet. Kam fituar shumë medalje për vendin tim dhe jam shumë krenar që jam pëzgjedhur për të qenë ndezësi i flakës në stadiumin Olimpik.

E kam marrë flakën nga

Njeriu mbi deve

Ju gjithashtu mund të shtoni personazhe të tjera sipas dëshirës (duke përdorur fletët bosh si më poshtë), por kujdes t'i rendisni personazhet në rendin e nevojshëm (marrë nga/ kaloj tek).

Personi:

Unë jam:

E kam marrë flakën nga:

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Personi:

Unë jam:

E kam marrë flakën nga:

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Personi:

Unë jam:

E kam marrë flakën nga:

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Personi:

Unë jam:

E kam marrë flakën nga:

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Personi:

Unë jam:

E kam marrë flakën nga:

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Personi:

Unë jam:

E kam marrë flakën nga:

Unë duhet t'ia kaloj flakën:

Shtojca III

Stafeta e pishtarit në Lojërat Olimpikë Rio 2016

Çdo stafetë e pishtarit është e ndryshme, dhe ofron mundësinë për të mësuar në lidhje me historinë dhe kulturën e një vendi tjetër të botës. Dizajni i pishtarit Olimpik i jep vendit mikpritës mundësinë të shprehë identitetin e tij. Për Lojërat e Rios 2016, dizajni inovativ është frymëzuar nga ngrohtësia e popullit Brazilian dhe përmban segmente që zgjerohen vertikalisht të cilat përfaqësojnë ngjyrat e Brazilit, kur flaka kalon nga një mbajtës pishtari tek tjetri. Profili i trekëndëshit të pishtarit është një referencë për tre vlerat Olimpikë, atë të ekselencës, miqësisë dhe respektit, ndërsa efekti lundruar i seksioneve të ndryshme simbolizon performancën e atletëve. Thyerjet horizontale në pishtar përfaqësojnë qiellin, malet, detin dhe tokën, të shëtitores së Kopakabanas.

Pas ceremonisë tradicionale Olimpikë të ndezjes së flakës në Olimpia në Greqi, për Lojërat Olimpikë të Rio 2016, pishtarit do t'i duhen nga 90 deri në 100 ditë që të arrijë në Brazil. Rreth 12.000 pishtarë mbajtës do të kalojnë flakën dorë më dorë në një distancë prej rreth 20.000 kilometra nëpër territorin e Brazilit. Flaka do të fluturojë 16,000km në veri dhe perëndim të vëndit, nëpër mes qyteteve të Teresinas deri në atë të Campo Grandes. Karvani i Pishtarit Olimpik të Rios 2016 do të kalojë nëpër 500 qytetete, në 300 prej të cilëve do të mbahen evente të ndryshme, dhe në 200 të tjerat do të mund të shihet kalimi i Flakës Olimpikë.

Informacion te metejshem:

<http://www.rio2016.com/tochaolimpica/en>